



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-CC-2020-11

Vendosi: **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**
Gjykatës Vidar Stensland, kryegjykatës
Gjykatës Antonio Balsamo
Gjykatës Roumen Nenkov

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 24 shtator 2020

Gjuha: Anglishte

Emri i dosjes: Referim i amendamenteve të propozuara të Kushtetutës së Kosovës

Klasifikimi: Publik

Vendim për gjuhën e punës

Kryetares së Kuvendit të Kosovës
Vjosa Osmani - Sadriu

1. Më 18 shtator 2020, Kryetarja e Kuvendit të Kosovës i përcolli Kryetares së Dhomave të Specializuara një amendament të propozuar kushtetues që ka të bëjë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, në përputhje me nenet 144(3) dhe 162(3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Referimi").¹ Kryetarja e Kuvendit të Kosovës kërkoi nga Kryetarja e Dhomave të Specializuara që t'ia caktojë Referimin për shqyrtim Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese. Më 22 shtator 2020, Kryetarja e Dhomave të Specializuara caktoi panelin e lartshënuar që të vendosë për Referimin.²

2. Paneli vë në dukje se neni 20 i Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, dhe veçanërisht rregulla 5 e Rregullores së Punës për Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, parashohin që paneli vendos për gjuhën e punës për procedurat e veta. Paneli vë në dukje se letra e Referimit është shkruar në anglishte. Duke marrë parasysh këtë fakt, paneli vendos që gjuha e punës për procedurën aktuale të jetë anglishtja.

PËR KËTO ARSYE, PANELI I GJYKATËS KUSHTETUESE

Vendos që gjuha e punës e procedurës aktuale të jetë anglishtja me përkthim zyrtar me shkrim dhe me gojë të siguruar nga Zyra Administrative në gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara, gjegjësisht, shqipe, serbishte dhe anglishte.

/nënshkrimi/

Gjykatës Vidar Stensland
Kryegjykatës

Hartuar në anglishte të enjten, 24 shtator 2020

Në Hagë, Holandë

¹ KSC-CC-2020-11, F00001, Letër e Kryetares së Kuvendit të Kosovës, publike, 18 shtator 2020, me shtojcën A01 (të protokolluar më 21 shtator 2020)

² KSC-CC-2020-11, F00002, Vendim për caktimin e panelit të Gjykatës Kushtetuese, publik, 22 shtator 2020